



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Nr. 703 prot.

Tiranë, më 27.4.2022

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTEGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, Ligjit 25/2019 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore” shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Oficer Policisë Gjyqësore, Sektori Task Forca**, në Drejtorinë e Hetimit.
- Kategoria C1/ III-b, 1 (1 pozicione pune)

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Mastër Profesional në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, ose të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Specialist i Task Forcës, (OPGJ) përgjigjet tek Përgjegjësi i Sektorit të Task Forcës për dosjen në lidhje me shkeljen e verifikuar dhe të hetuar nga ana e tij, në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor dhe penal duke redaktuar edhe relacionin përfundimtar për çështjen.
- Kryerja e veprimeve hetimore të urdhëruara/deleguara nga Prokurori kompetent.
- Kryerja e veprimeve hetimore/verifikuese, të kërkuara nga Autoritetet doganore të huaja, me të cilët D.P Doganave ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi dhe ndihme reciproke.
- Përpilim i shkresave/korespondencave të ndryshme me institucione të ndryshme shqiptare dhe subjekte të ndryshme.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim (e-mail, dhe numër telefoni)
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe lista e notave të noterizuara
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër referencë dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Përvojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 06 .05 .2022, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

